



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:153917

Datë: 08.12.2020

Numri i dokumentit: 01326219

PKR.nr.1006/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA, Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja Violeta Namani-Hajra, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shpresa Sahiti, në lëndën penale kundër të pandehurit **E. M.** për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par .1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, PP.I.nr.406/20, të datës 30.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 27.11.2020, në prezencë të prokurorit të shtetit, të pandehurit Edon Mulaj, gjykata në të njëjtën ditë mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri E. M., nga i ati B., dhe nëna E.,e gjinisë A., i lindur me datë *data e lindjes...*,në Prishtinë ku edhe jeton në rrugën “E. Q.”, Lagja Bregu i diellit, i martuar , studentë, punon si Asistentë në Fakultetin e Artit, me gjendje të mesme ekonomike, me numër personal *numri...*, shqiptar , shtetas i R. të Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:-

Me datë 24.08.2020, rreth orës 22:45, në rrugën “A. R.”, në Prishtinë, gjatë një kontrole nga ana e policisë, është ndaluar i pandehuri E. M. me ç’rast në veturën e tij të tipit “Audi A6”, me targa *numri...*, i është gjetur një thikë e tipit “Magnum”, me kallëf lëkurë, me madhësi tehu 16.5 cm, të cilën i pandehuri e posedonte pa autorizim, e cila është konfiskuar nga ana e policisë,-

-Me këtë ka kryer veprën penale në Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par .1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform neneve 38, 40, 43, dhe nenit 366 par .1 të KPRK-së dhe neneve 365, 450 të KPP, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumë prej **200 (dyqind €)**, të cilin dënim i pandehuri Edon Mulaj obligohet që ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se 3 muaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe me forma tjera bazuar në nenin 43 par.3 të KPRK, gjykata të njëjtin do ta shndërroj në dënim me burg, ashtu që për qdo **20 €** do ti llogaritet një ditë burg.

Të pandehurit Edon Mulaj i konfiskohet një thikë e tipit “Magnum” me kallëf lëkurë, me madhësi tehu 16.5 cm, si mjetë i kryerjes së veprës penale dhe e njëjta të shkatërrohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që ti paguaj të gjitha shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **30 (tridhjetë) €**, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.406/20, të datës 30.10.2020, kundër të pandehurit E. M. për shkak të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par .1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestarë me datën 27.11.2020 dhe pasi që i pandehuri E. M. është njoftuar me të drejtat e tij, ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën, nuk ka nevojë për sqarim shtesë dhe pasi i ipet mundësia që të pranoj, ose mos të pranoj fajësinë lidhur me veprën penale që i është vë në barrë, i pandehuri në kuptim të nenit 248 të KPRK-së e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe shton se më vjen keq që ka ndodhë ky rast dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do ta përsëris një veprim të tillë.

Prokurorja e shtetit në seancën fillestare deklaron pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit konsideroj se pranimi i fajësisë është bërë konforme dispozitave të procedurës penale dhe në përputhshmëri me provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës me të cilën vërtetohet se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe propozoj gjykatës të njëjtin pranim ta aprovoj dhe të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit, po ashtu të merret si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë nga ana i pandehuri E. M..

Meqë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për kryerjen e veprës penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat materiale që përmban aktakuza, dhe se nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik, Gjykata vlerësoj se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPRK-së, që të pranohet deklarata e të pandehurit E. M. për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj veprë penale, dhe të njëjtit edhe e ka aprovuar, duke mos administruar asnjë provë lidhur me vërtetësinë e gjendjes faktike.

Ashtu që, bazuar në një gjendje të tillë të pa kontestuar të fakteve, gjykata vërtetohet se në veprimet e të pandehurit E. M. manifestohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par .1 të KPRK-së.

Gjykata me rastin e matjes dhe përcaktimit të lartësisë dhe llojit të sanksionit penal për të pandehurin, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat relevante rënduese dhe lehtësuese, në kuptim të nenit 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese për të pandehurin, vlerësoi faktin se i njëjti e ka pranuar fajësinë në mënyrë shumë të sinqertë që nga fillimi i kësaj procedure penale, sjelljen

dhe qëndrimin e tij shumë korrekt në gjykatë, se kjo gjykatë nuk ka të dhëna se i njëjti ka qenë i gjykuar më parë, pendimi i thellë i tij për këtë vepër penale, të pandehurit ia shqiptojë sanksionin penal përkatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se një sanksion i tillë penal është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale dhe përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në riedukimin, risocializimin dhe parandalimin e të pandehurit dhe personave tjerë nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, me çka edhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm dhe i veçantë i dënimit konform nenit 38 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësorë, është marr konform dispozitave të nenit 450 par.2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Vendimi lidhur me konfiskimin e thikës së lartcekur është marrë konform nenit 366 par.3 të KPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr.1006/2020 dt.27.11.2020

Bashkëpuntore Profesionale:
Shpresa Sahiti

Kryetarja e trupit gjykues– gjyqtarja:
Violeta Namani-Hajra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së të njëjtit, e përmes kësaj gjykate.